



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 5.2.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Nenad Rashiq dhe Etem Arifi.

Munguan: Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu, Kujtim Paqaku dhe Mytaher Haskuka.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Fatlum Malushaj, praktikant në Kuvendin e Kosovës, Afrim Maliqi dhe Osman Shatri, HANDIKOS; Hajredin Skënderi, Swiss Embassy; Trina Binaku, YIHR; Teuta Prekazi, OKB për të drejtat e njeriut; Agim Mangilaj, CSGD; Hamzë Maliqi, SWOK; Genc Jaha, KDI; Kushtrim Haziri “ KosovaPress” ; Kosovare Maliqi, Rrokum TV; Ukë Gashi, ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.1.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe statusin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë;**

- 4. Shqyrtimi i peticioneve;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.1.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.1.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe statusin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Kryetarja prezantoi anëtarët e organizatës HANDIKOS dhe ia dha fjalën kryesuesit të grupit të punës, që të prezantojë punën e bërë.

Nenad Rashiq – Pasi falënderoi të pranishmit, prezantoi shkurtimisht punën e deritashme të grupit punues. Lidhur me këtë, ai theksoi se do të vendosin se a do të aprovohet ligji në tërësi, duke u fokusuar edhe në aktet në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohen mekanizma për mbrojtjen e interesave të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në një periudhë afatgjatë, por ishte i mendimit se sfidat buxhetore duhet të analizohen me kujdes. Ai i falënderoi përfaqësuesit e Ministrisë së Financave për informatat e sjella, me qëllim të sqarimit të koston së projektligjit në fjalë. Duke diskutuar për këtë, tha se kosto primare është 84.000 euro, duke marrë për bazë përfituesit, ndërsa kosto sekondare është 4.752.000 euro. Lidhur me këtë, theksoi se është shumë me rëndësi të informohen se çka nënkuptojnë me kosto primare dhe kosto sekondare. Në vazhdim, theksoi se nga konkludimet e tyre duhet të bëjnë pyetje se a janë në gjendje të ofrojnë rehabilitimin apo institucione që do të rehabilitojnë personat përfitues të këtij ligji. Po ashtu, sqaroi se nuk ka kushte që në start të ofrojnë rehabilitimin si duhet, mirëpo duhet që në të ardhmen të jetë qëllim strategjik, pasi që për momentin nuk është e mundur që të ofrohet rehabilitimi adekuat. Ai, po ashtu, theksoi se me qëllim që ligji të jetë sa më mirë i plotësuar, duhet që t'i sigurojnë pajisjet e nevojshme për këtë kategori, siç janë karrocet e ndryshme. Ai theksoi se kanë analizuar edhe çmimin e këtyre karrocave, të cilat krijojnë kosto të caktuar financiare, e cila në të ardhmen duhet të kompletohet. Lidhur me kohën e nxjerrjes së akteve nënligjore, theksoi se kanë propozuar që mos të jetë afati i nxjerrjes së tyre një vit, por të jetë gjashtë muaj, sepse do të ndikojnë pozitivisht në implementimin sa më të mirë të ligjit në vitin 2017. Pas miratimi të ligjit dhe akteve nënligjore, është me rëndësi të kontrollohet, në vazhdimësi, zbatimi i këtij ligji. Lidhur me planifikimet buxhetore, theksoi se kanë kërkuar informacione shtesë rreth koston primare dhe sekondare, me qëllim që të jenë sa më të saktë në planifikimet buxhetore.

Si sfidë të dytë, paraqiti identifikimin e institucionit kompetent për përkujdesjen për këtë ligj. Ai tha se duhet të vendoset se cila ministri është kompetente për zbatimin e ligjit. Përveç dy sfidave strategjike, theksoi se janë edhe sfidat financiare, që ndërlidhen me pajisjet dhe çmimin e tyre, në mënyrë që të planifikohen dhe të nxirren nga buxheti. Gjithashtu, tha se duhet të përcaktohet në ligj se a është e nevojshme, që pas 5 viteve, të bëhet rifurnizimi me karroca, sepse karrocet shërbejnë deri në 5 vite. Rreth fillimit të zbatimit të ligjit, tha se do të propozojnë datën 1 janar 2017, si datë e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Kryetarja falënderoi përfaqësuesit e HANDIKOS-it dhe i informoi se e kanë gjithë materialin dhe janë të gatshëm të organizojnë dëgjimin publik, në të cilin do të paraqiten propozimet e tyre, por edhe të subjekteve të tjera, lidhur me këtë projektligj.

Nenad Rashiq – Lidhur me këtë, theksoi se ligji duhet të miratohet, duke përfshirë të gjitha sfidat e theksuara. Ai kërkoi që paraprakisht ata të dakordohen me Komisionin për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që pas prezantimit të amendamenteve, mos të paraqiten pengesa procedurale, që do të ndikojnë në përfshirjen e tyre në projektligj.

Ai ishte i mendimit që mos të mbahet dëgjimi publik, derisa ata të kompletojnë projektligjin, sepse nëse paraqiten modifikime të tjera, do të vihet në pikëpyetje puna e deritashme e grupit punues. Lidhur me takimet e radhës të grupit punues, ishte i mendimit që gjatë javës pasuese, të mbahet një takim.

Salihe Mustafa – Lidhur me punën e grupit punues, theksoi se është bërë shumë punë deri më tani dhe falënderoi HANDIKOS-in dhe KDI-në për kontributin e dhënë në realizimin e hulumtimit. Lidhur me projektligjin, ajo theksoi se është sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit, mirëpo sa i përket implementimit të tij, i takon Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë dhe komunave. Duke i ditur nevojat e kësaj kategorie, tha se ligji doemos duhet të jetë i implementueshëm, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së tyre mjaft të vështirë. Ajo, në vazhdim, tha se shëndetësia primare është kompetencë e komunave, mirëpo si Komision, do të caktojë sesi duhet të vijë deri tek pacienti shëndetësia primare. Në fund, ajo tha se në javën pasuese do të precizojnë qëndrimet e tyre më mirë, në diskutim me përfaqësuesit e HANDIKOS-it, sepse ata janë kërkues të këtyre shërbimeve dhe e njohin situatën dhe nevojat e tyre, më mirë.

Nenad Rashiq – Ishte i mendimit se nuk do të mund t'i mbikëqyrin të gjitha komunat, dhe pikërisht, për këtë shkak, ka kërkuar që të jetë Ministria e Shëndetësisë apo Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, apo të dyja bashkë, duke e ditur që është shumë më lehtë të mbikëqyrin të dyja dhe duke pasur parasysh që kanë punëtorë në terren, do të kishin mundur që të përkujdesën më mirë për këtë çështje, sesa komunat. Ai shfaqti dilemat e tij se ky ligj do të implementohet, ashtu siç duhet, nëse mbetet në kompetencë të komunave.

Kryetarja – Duke e ditur rëndësinë e propozimeve dhe të projektligjit, theksoi se do të dakordohen edhe si Komision, bashkë me komisionet tjera, duke mos i tejkaluar edhe afatet ligjore, sepse ato duhet patjetër t'i respektojmë.

Nenad Rashiq – Kërkoi që paraprakisht t'i aprovojnë këto propozimet aktuale, në mënyrë që të mund të inkorporohen në ligj, pastaj, në fund, të aprovohen së bashku.

Mexhide Mjaku- Topalli –Theksoi se është e nevojshme që të mbahet edhe një takim lidhur me amendamentet e projektligjit, me qëllim të harmonizimit të propozimeve që kanë dalë nga HANDIKOS-i dhe Komisioni. Në fund, të dalin para Komisionit dhe të miratohen, mirëpo do të jetë me rëndësi edhe dëgjimi publik, për identifikimin e propozimeve që dalin aty, në mënyrë që të inkorporohen në projektligj. Lidhur me shkresën e Ministrisë së Financave, tha se nuk kanë marrë asnjë vendim, vetëm i ka paraqitur të dhënat, ndërsa asgjë nuk është vendimtare, pra se a po i përgjigjet ligjit që është paraparë apo jo. Po ashtu, tha se është e nevojshme të takohen me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe pastaj të vendosin tutje. Lidhur me propozimin e bërë nga HANDIKOS-i, ishte e mendimit se nuk është e nevojshme që paraprakisht të precizohet kostoja financiare, mirëpo është e nevojshme që të bëhet në fund, pasi që të përfundojë rehabilitimi, në mënyrë që të jenë paraqitur të gjitha aktivitetet të cilat duhet të përfshihen në kosto, e pastaj Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ta realizojë pagesën.

Salihe Mustafa – Duke u ndërlidhur me fjalën e parafolësës, theksoi se amendamentet e paraqitura nuk janë përfundimtare. Sipas saj, këto propozime do të diskutohen në Komision, por edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që mos të kenë më pas përgjigje negative nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kryetarja – Falënderoi grupin punues për punën e deritashme dhe theksoi se duhet ta marrin edhe aprovimin e komisioneve të tjera, e pastaj të vazhdojnë tutje.

4. Shqyrtimi i peticioneve

Kryetarja – Lidhur me shkresën e zëvendësit të Avokatit të Popullit, z. Bogoljub Staletoviç, tha se ai e ka dërguar shkresën edhe tek Kryeparlamentari dhe është e nevojshme që të presim, në mënyrë që të harmonizohen qëndrimet bashkërisht, e më pas të vendoset lidhur me këtë çështje.

Po ashtu, i informoi anëtarët rreth kërkesës së z. Refki Jasharit, i cili ka paraqitur në Komision ankesën e tij rreth refuzimit të kërkesës për njohjen e invaliditetit gjatë kohës së luftës. Ajo, në vazhdim, theksoi se kërkesa e paraqitur nuk është bërë në adresën e duhur.

Pas një debati, lidhur me këtë kërkesë, Komisioni nxori këtë

P Ë R F U N D I M

- I. Kërkesa e paraqitur nga Refki Jashari rreth refuzimit të kërkesës së tij për njohjen e statusit të invalidit të luftës, nuk bie në fushëveprimin e Komisionit.
- II. Udhëzohet z. Refki Jashari, që këtë kërkesë ta paraqesë në Komisionin Qeveritar për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Veteranit, Invalidit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të UÇK-së, pasi që ata janë kompetentë për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

5. Të ndryshme

Kryetarja i informoi anëtarët e Komisionit, se kanë marrë një plotësim lidhur me Planin e punës së Komisionit nga Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore. Në vazhdim, theksoi se e kanë miratuar Planin e punës për vitin 2016, në të cilin është paraparë një aktivitet për komunitetin LGBT dhe në vazhdim do të analizojnë mundësinë e inkorporimit të kërkesave për aktivitete të tjera lidhur me këtë komunitet.

Po ashtu, ajo shprehu falënderim në emër të Komisionit për miratimin e Rezolutës së Parlamentit Evropian, në të cilën bëhet fjalë për perspektivën e mirë evropiane të shtetit tonë dhe përkujdesjet për të pagjeturit, duke i obliguar që të dy qeveritë të bashkëpunojnë, me qëllim të arritjes së rezultateve pozitive lidhur me gjetjen e personave të zhdukur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit

Lirije Kajtazi